



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
ŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 400/05-43877
Dt: 18.08.2025

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 12 të Rregullores MF04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, me datën 18.08.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e komuniteteve

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e komuniteteve.
2. Thirrja publike sipas pikës një(1) të këtij vendimi bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim nga linja e subvencioneve të Komunës së Gjakovës.
4. Dokumentacioni përkatës i nevojshëm dhe kriteret për aplikim për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e komuniteteve do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.
5. Formimi i Komisionit vlerësues, vlerësimi i aplikacioneve, procedurat e nënshkrimit të kontratës, do të zhvillohen në bazë të dispozitave të Rregullores MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

